



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.30.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT RREGULLATIV
TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Maj 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të 2014 në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga, Sabile Musa (Udhëheqës Ekipi), dhe Refiqe Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	9
4 Qeverisja.....	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	18
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	21


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 12/11/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:


Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm

Ne ishim në gjendje të marrim siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale dhe qeverisjen e përgjithshme në shumicën e fushave, por kemi identifikuar dhe disa dobësi jo sinjifikante të menaxhimit financiar. Dobësitë e identifikuara janë të shpjeguara më në detaje në brendi të raportit, dhe janë dhënë rekomandime praktike për trajtimin e dobësive.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Kryetarit – Auditimit 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e Auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga kryetari. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë raport Kryetari është pajtuar.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Disa deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Cilësia e PVF-ve ishte e mirë. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF të cilës i jemi referuar më lart, ishte e saktë në të gjitha aspektet.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (SNISA 200/1700 Opinion i Pamodifikuar).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

PVF-të duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rr. F nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048; dhe
- SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkludimi ynë është se ARKEP ka marr në konsideratë rekomandimet tona të vitit të kaluar. Përkundër angazhimit të menaxhmentit, masat e ndërmarra për adresimin e rekomandimeve nuk ishin efektive në rregullimin e disa çështjeve prezente. Prandaj ARKEP duhet të shtoj angazhimin drejt trajtimit të plotë të tyre. Theks i veçantë duhet ti vihet shpenzimit të buxhetit në fushën e Investimeve Kapitale.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2013 të ARKEP-it kanë rezultuar në 10 rekomandime kryesore. ARKEP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, katër (4) rekomandime janë adresuar plotësisht; tri (3) janë adresuar pjesërisht, dhe tri (3) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Përkundër angazhimit të menaxhmentit dhe përgatitjes së planit për veprimet e ndërmarra për të adresuar rekomandimet e vitit të kaluar, ARKEP ka hasur në vështirësi në zbatimin e plotë të disa rekomandimeve të AP-së.
- Kjo në një masë është ndikuar edhe nga aktivitetet e qeverisë (mos krijimin e bazës ligjore) lidhur me inicimin e prokurimit për tri projekte¹. Projekti nr. 1 – nuk ka arritur të realizohet si rrjedhojë e pamundësisë për të siguruar kodin shtetëror të Kosovës; Projekti nr. 2 dhe 3 – ndërlidhet me faktin se Qeveria ende nuk e ka proceduar projektligjin për procedurat e inkasimit të detyrimeve doganore për pajisjet fundore-telefonat celular.
- Rreziku** Vështirësitë si në planifikimin ashtu edhe në realizimin e buxhetit për Investime Kapitale, si dhe disa mangësi në fushën e prokurimit kanë rezultuar në:
- Mos kryerjen e projekteve dhe dështimi në realizimin e buxhetit të planifikuar. Kjo mund të ndikojë në zvogëlimin e buxhetit për vitet e ardhshme; dhe
 - Në shfaqjen e sfidave të njëjta të shpenzimeve dhe praktikave të prokurimit.
- Rekomandimi 1** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

¹ Krijimi i njësive për menaxhimin e Kryedomenit Shtetëror të Internetit; Ngritja e Platformës Softuerike dhe Harduerike për Regjistrimin e Pajisjeve me Identitet; dhe Blerja e pajisjeve për identifikimin e telefonave mobil.

4 Qeverisja

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

ARKEP ka një plan të organizimit të tyre, të përcaktuara dhe lokalizuara përgjegjësitë dhe të identifikuar linjat e raportimit për të gjitha aspektet operacionale të saj, duke përfshirë kontrollet. Delegimi i autoritetit dhe përgjegjësi është i specifikuar në mënyrë të qartë. Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga ARKEP. Vetëvlerësimi, është përgatitur dhe dorëzuar me kohë në të cilën janë paraqitur komponentët e caktuara të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kontrollet efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të bëhet në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar me përjashtim të disa dobësive të cekura në këtë raport.

Në po ashtu kemi gjetur se, ndërkohë që kontrollet mbi të hyrat janë të forta dhe po zbatohen në mënyrë efektive, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që ARKEP të sigurojë buxhet të mjaftueshëm, në mënyrë që projektet të jenë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë Prokurimi dhe Ekzekutimi i Buxhetit për Investimet Kapitale, megjithëse duhet të cekim se çështjet e paraqitura për procedurat e prokurimit vijnë si pasojë e mbetjes vakante të pozitës së Menaxherit të Prokurimit.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ARKEP, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,219,107	965,113	780,465	682,713	632,279
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,219,107	955,206	776,034	682,713	632,279
Donacionet e jashtme		9,907	4,431		

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 253,994€. Kjo zbritje është shkak i pamundësisë së realizimit të projekteve kapitale. Kjo zbritje është zbatuar pas rishikimit buxhetor dhe sipas vendimeve të Qeverisë.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Në vitin 2014, ARKEP ka realizuar 81% të buxhet final ose 780,465€, me përqindje të njëjtë krahasuar me vitin 2013. Megjithatë, ekzekutimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,219,107	965,113	780,465	682,714	632,279
Pagat dhe Mëditjet	309,088	320,111	320,111	289,558	266,487
Mallrat dhe Shërbimet	397,319	337,302	249,543	259,370	251,088
Shërbimet komunale	12,700	12,700	11,213	12,390	11,034
Investimet Kapitale	500,000	295,000	199,598	121,396	103,670

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Pavarësisht zbritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 68% e buxhetit të mbetur ishte shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshinte tetë projekte për vitin aktual. Gjatë vitit është realizuar vetëm një projekt. Janë tri arsye kryesore të e performancës së ulët në realizimin e projekteve kapitale. Arsyeja e parë lidhet me politikat e Qeverisë së Kosovës (tre projekte), arsyeja e dytë ka të bëjë me mungesën e ofertave të mjaftueshme (dy projekte) dhe arsye e tretë është vonesa në përgaditjen e procedurave të prokurimit respektivisht zhvillimin me kohë të specifikacioneve të projekteve nga ana e njësisve të kërkesës (tre projekte).
- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 11,023€ dhe zvogëlimi tek Mallrat dhe Shërbimet për 60,017€ është si rezultat i realizimit të vendimit të qeverisë për rritjen e pagave prej 25% dhe zvogëlimin e mallrave dhe shërbimeve për 15%. Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshin gjithashtu donacionin e jashtëm prej 9,907€.

Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetanake	4,125,000	4,125,000	3,941,666	5,524,640	5,749,363
Totali	4,125,000	4,125,000	3,941,666	5,524,640	5,749,363

Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një zvogëlim i realizimit të të hyrave. ARKEP për vitin 2013 kishte një projekt për 3G dhe 4G që ka ndikuar në realizimin më të lartë të të hyrave për atë vit.

Veprimtaria e ARKEP-it financohet nga paratë të cilat mblidhen përmes aplikimit transparent të tarifave rregullatore në pajtim me ligjin e Komunikimeve Elektronike. Ndërmarrësit që ofrojnë

rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve dhe qarkullimi i të cilave është mbi 100,000€, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike të kryer nga ARKEP-i . Kjo pagesë bëhet për t'i mbuluar kostot administrative të Autoritetit. Tarifa nuk duhet të jetë më shumë se 0,5% e të hyrave vjetore të vitit paraprak kalendarik.

Çështja 2 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit është përafërsisht i njëjtë për vite dhe nxjerr në pah një nivel të vazhdueshëm të ulët të ekzekutimit.. Theks i veçant duhet t'i vihet ekzekutimit të buxhetit në fushën e Investimeve Kapitale.
- Rreziku** Ekzekutimi i ulët i buxhetit do të rezultojë në shfrytëzim joefikas të burimeve dhe e redukton efektivitetin e planeve të shpenzimeve të Organizatës.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të vlerësoj në mënyrë sistematike arsyet për ekzekutim të ulët të buxhetit dhe të përcaktoj praktikat për përmirësim dhe të adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

ARKEP realizon të hyra nga: taksat administrative, mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike, nga përdorimi i frekuencave, nga numeracionet dhe nga masat ndëshkuese. Për vitin 2014 të hyrat e grumbulluara ishin prej 3,941,666€ ose 96% në raport me planifikimi e tyre. Derisa të hyrat e përealizuara (të faturuara) nga vitet e kaluara kapin vlerën prej 142,588€. Për vitin 2014 janë planifikuar të hyra në vlerë 4,125,000€, ndërsa janë realizuar 3,941,666 ose 96% në raport me buxhetin final.

Rekomandimet

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në vitin 2014, ARKEP kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe ka nënshkruar kontrata në vlerë prej 257,947€. Vetëm një prej tyre është investim kapital me vlerë prej 199,598€ e realizuar në fund të vitit. ARKEP, ishte përballur me sfida në fushën e prokurimit të cilat vinin si pasojë e mungesës së menaxherit të zyrës së prokurimit. Në pamundësi për të plotësuar me kohë këtë pozitë, ARKEP nga tetori i vitit 2014 lidh marrëveshje me Komisionin e Pavarur për Media (KPM) për marrjen e shërbimeve të prokurimit nga Menaxheri i Prokurimit të KPM-së. Pastaj kanë vazhduar aktivitetet dhe procedurat e prokurimit me qëllim të realizimit të planit të prokurimit. Megjithatë për shkak të vëllimit dhe arsyeve të cekura në kapitullin 4.3, plani i prokurimit mbetet i porealizuar në përgjithësi, sidomos për projektet në fushën e Investimeve Kapitale.

Bazuar në këtë ne identifikuar disa çështje si në vijim:

Çështja 3 – Procedurat e Prokurimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit të kryera, ne kemi identifikuar mangësi të përbashkëta, të cilat kanë pasur ndikim mbi kontratat e rishikuar. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet e mëposhtme:

- Në njërin proces³, dosja e Operatorit Ekonomik (OE) fitues përmbante dy çmime të ndryshme.⁴ Për më tepër, raporti i vlerësimit të ofertave nuk përmbante dëshmi nëse janë kërkuar sqarime nga OE dhe nëse ky ka pranuar vlerën e korigjuar aritmetike;
- Në procesin tjetër⁵, çmimi i kontratës ishte 3,645€, derisa përmbrenda kontratës në nenin 3.3 ceket se shuma e furnizimeve nuk mund të tejkaloj shumën e 10,000€. Në këto situata përpilimi i kontratës nuk është azhurnuar plotësisht sipas kërkesave të tenderit; dhe
- Në një rast Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve ishte nënshkruar pas raportit të vlerësimit nga komisioni për vlerësimin e ofertave. Në njërin rast Plani për menaxhimin e kontratës nuk ishte nënshkruar as nga ana e ARKEP dhe as nga OE.

³ Furnizim me material shpenzues

⁴ Formulari i përshkrimit të çmimit ka vlerën 9845€, ndërsa Formulari i paraqitjes së kuotimit të çmimit ka vlerën 9830€

⁵ Lënda Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve të IT

Rreziku Ekziston rreziku qe si rezultat i mungesës se kontrolleve efektive gjatë procedurave të prokurimit mund të bëhen pagesa të parregullta, vonesa në ofrimin e shërbimeve, si dhe vlerë e dobët për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe për të vënë kontrolle më të fuqishme për të siguruar se dobësitë sistematike janë eliminuar.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Ne kategorinë e shpenzimeve tjera jo përmes prokurimit, ne kemi testuar disa pagesa përfshirë dhe pagesat për udhëtime jashtë vendit. Ne identifikuam çështjen si në vijim, për të cilën ARKEP kanë marr masa pas këshillave tona të auditimit të ndërmjetëm.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagave (payroll). ARKEP ka kontrolle adekuate në përgatitjen e listave të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme si dhe ne harmonizime me Ministrin e Administratës Publike (MAP) dhe me Ministrin Financave (MF).

Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 320,110€, dhe shpenzimet ishin 320,110€ ose 100%. Numri i nëpunësve të planifikuar ishte 39. Numri aktual i të punësuarve në Payroll është 35, prej tyre pesë janë anëtar të Bordit dhe një zyrtar është në pushim pa pagesë.

Nga kalkulimet e bëra lidhur me procesin e shpenzimeve për Paga dhe Mëditje në ARKEP, kemi vërejtur një gabim lidhur me kalkulimin e pagave tek pesë anëtarët e Bordit. Është përfshirë rritja prej 25% në pagën e tyre bazë edhe përkundër që vendimi i Qeverisë nuk përfshin Bordet dhe të emëruarit e Agjensioneve të pavarura në rritjen e pagave.

Menjëherë pas pranimit të listës së pagave, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i ARKEP ka bërë reagimin me kërkesë për korrigjim të listës së pagave para ekzekutimit të pagave për muajin Prill. Në dhjetor është bërë korrigjimi i duhur.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK), me vlere mbi 1,000€ pasuri jo-financiare kapitale të ARKEP-it ishin 1,156,000€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Gjithashtu, ne kemi verifikuar nëse ekziston fizikisht pasuria e evidentuar në regjistrat e pasurisë.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime tjera në këtë fushë

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Të hyrat e pa mbledhura dhe të prezantuara në PVF ishin 142,588€. Prej tyre 87,273€ janë fatura të papaguara nga vitet paraprake, ndërsa 55,315€ janë fatura të papaguara të periudhës 2014.

ARKEP, bazuar në kornizën ligjore, ka përdorur të gjitha procedurat e mundshme për të inkasuar të arkëtueshmet e tyre. Në raste të mos ekzekutimit të urdhrave dhe dënimeve nga shkelësit/kundërvajtësit, ARKEP, ka proceduar inicimin e procedurave gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

ARKEP, në vitin 2013 ka raportuar obligime të papaguara në pajtim me kërkesat e rregullores financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore dhe në pajtim me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2014 ishte në shumën 853€. Këto detyrime janë ndaj faturave të muajit dhjetor 2014 dhe janë bartur për t'u paguar në vitin 2015.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Çështja 4 - Themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas UA.nr.23/2009 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) , ARKEP i plotëson kushtet për themelimin e kësaj njësie. Megjithatë, ARKEP ende nuk ka marrë një aprovim pozitiv për këtë çështje nga ana e MF-së. Ky funksion është përmbushur përmes NjAB-së nga MF, e cila. Sipas letër angazhimit, fushëveprimi i auditimit mbulon periudhën 2013 dhe 2014. Objektiva e auditimit mbulon planifikimin dhe realizimin e buxhetit, shpenzimet, procedurat e inkasimit të të hyrave dhe procedurat e personelit. ARKEP ka pranuar raportin e auditimit të rregullsisë nga NJAB në MF, i cili ka vlerësuar efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxheriale dhe ka paraqitur dy rekomandime që pritet të zbatohen nga ARKEP.
- Rreziku** Mos themelimi i NJAB-së (sipas legjislacionit) mbrenda institucionit nuk ofronë siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e Kontrolleve të Brendshme në organizatë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të vazhdoj përpjekjet deri në themelimin e NJAB-së. Në mungesë të kësaj njësie, shërbimet e auditimit të brendshëm duhet të sigurohen në një mënyrë tjetër.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionimi i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryetari i Bordit duhet të siguroj një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të AP-së, duke i përcaktuar qartë afatet kohore dhe anëtarët e stafit llogaridhënës. Adresimi duhet të behet sipas prioriteteve, me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe.	Po		
2 - Realizimi i Buxhetit	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një analizë dhe vlerësim kritik mbi planifikimin e detajuar të projekteve kapitale duke marr parasysh edhe mundësitë dhe pengesat që mund të dalin gjatë realizimit të tyre.			Jo
3 - Lidhja e kontratës në mungesë të dokumenteve të kërkuara	Kryetari i Bordit duhet të siguroj kontrole shtesë në proceset e prokurimit, përkatësisht në dokumentimin dhe ruajtjen e të dhënave të prokurimit. Dokumentet shtesë që kërkohen prej fituesit të kontratës duhet t'i bashkëngjiten dosjes së prokurimit.	Po		
4 - Nxjerrja e urdhër blerjes pas pranimit të Faturës	Kryetari i Bordit duhet të sigurohet që të forcoj kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave duke siguruar procesimin e tyre në pajtim me hapat e përcaktuar me LMFPP dhe me rregulla të thesarit.			Jo
5 - Mungesa e evidencave për	Kryetari i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për të përmirësuar kontrollet mbi		Pjesërisht -Rekomandimi për vitin 2014 nuk është zbatuar, megjithëse	

shpenzimet e karburanteve	menaxhimin dhe shfrytëzimin e karburanteve. Lidhur me këtë duhet të mbahen evidenca bazuar në dokumentet burimore, dhe bazuar në to të behën pagesat e shpenzimeve.		ka filluar të zbatohet në shkurt të vitit 2015.	
6 - Kalkulimi i çmimit mesatar sigurohet nga Operatori	Kryetari i Bordit duhet të shqyrtoj mundësinë për të siguruar çmimin mesatar të berëzës nga burime të palëve të treta, qoftë nga Zyra e Kryeministrit ose ndonjë institucion tjetër që ka të njëjtat informata.			Jo
7 - Mungesë e protokollimit të faturave	Kryetari i Bordit duhet të siguroj se në harmoni me rregullën financiare mbi shpenzimin e parave publike të protokolloj secilën faturë të pranuar.	Po		
8 - Mos vlerësimi i performancës së stafit për vitin 2013	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë, se nëpërmjet zyrtarëve përgjegjës të njësive përkatëse, janë kryer më kohë të gjitha vlerësimet vjetore të punës për të gjithë punësuarit. Ky proces do të mundësoj identifikimin e fushave me mangësi me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm.	Po		
9 - Evidenca jo të plota lidhur me menaxhimin e automjeteve	Kryetari i Bordit duhet të shqyrtoj mundësinë të rishikoj edhe njëherë rregulloren për menaxhimin e automjeteve, duke eliminuar mundësinë për përdorimin e tyre për qëllime private. Kontrole shtese nevojiten edhe në evidentimin rreth menaxhimit të automjeteve.		Pjesërisht- Është bërë miratimi i rregullores të brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare të ARKEP-it. Megjithatë ka mangësi në evidencat për shfrytëzimin e automjeteve.	
10 - Themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm	Kryetari i Bordit duhet të vazhdoj përpjekjet deri në themelimin e NJAB-së. Deri në themelimin e kësaj njësie, shërbimet e auditimit të brendshëm duhet të sigurohen në një mënyrë tjetër.		Pjesërisht- NJAB nuk është themeluar. Mirëpo NJAB pranë MF ka kryer auditimin me kërkesën e ARKEP-it.	